



## REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

PAKR.nr.99/21

### NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS** – Departamenti për krime të rënda, kolegji i përbërë nga gjyqtarët Abdullah Ahmeti, kryetar, Dr.sc.Driton Muharremi e Vaton Durguti, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Leonita Lajçi procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarit S.K., nga Peja, për shkak të veprës penale Falsifikim i Rezultateve të Votimit nga neni 219 par.2 lidhur me par.1 të ish KPRK-së,(nr.04/L-082), duke vendosur lidhur me ankesën e mbrojtësit të akuzuarit S.K., të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore-Departamenti për Krime të Rënda në Pejë PKR.nr.252/2020 dt. 30.01.2021, me datë 29.03.2021 morri këtë :

### A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e mbrojtësit të akuzuarit S.K., ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore-Departamenti për Krime të Rënda në Pejë PKR.nr.252/2020 i dt. 30.01.2021, vërtetohet.

### A r s y e t i m

Gjykata Themelore Departamenti për Krime të Rënda në Pejë, me aktgjykimin PKR.nr.252/2020 i dt. 30.01.2021, të akuzuarin S.K. e ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale Falsifikim i Rezultateve të Votimit nga neni 219 par.2 lidhur me par.1 të ish KPRK-së,(nr.04/L-082) dhe i ka shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohet në rast se i akuzuari nuk kryen ndonjë vepër të re penale brenda periudhës 1 (një) vjeçare. I akuzuari është obliguar që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësorë gjykatës ti paguaj shumën prej 30 euro, dhe shumën prej 50 euro euro në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit, të gjitha në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Refuzohet propozimi i prokurorisë që konform nenit 65 të KPRK-së të akuzuarit ti shqiptohet dënimi plotësues ndalimi i ushtrimit të funksionit në administratën publike apo shërbimin publik.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ankesë ka ushtruar:

- Mbrojtësi i të akuzuarit S.K. av.Dritëro Kollçaku, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe vendimit mbi dënimin, me propozim që Gjykata e Apelit aktgjykimin e ankimuar ta anuloi dhe çështjen ta kthej në rigjykim dhe rivendosje.

-Prokurori i Apelit në parashtresën PPA/I.nr.111/21 të dt. 10.03.2021 ka propozuar që të refuzohet si e pabazuar ankesa e mbrojtësit të akuzuarit S.K. av. Dritëro Kollçaku dhe aktgjykimi i shkallës së parë të vërtetohet.

Gjykata e Apelit e Kosovës konform nenit 394 par.1 të KPP-së shqyrtoi shkresat e lëndës, vlerësoi aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore të mbrojtësit të akuzuarit dhe gjeti se :

**-ankesa nuk është e bazuar.**

Mbrojtësi i të akuzuarit me ankesë pretendon se aktgjykimi i ankimuar është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale sepse nuk janë plotësuar kushtet nga neni 248 i KPP-së për pranimin e fajësisë. Sipas mbrojtjes i akuzuari ka bërë pranimin e fajësisë në shqyrtimin fillestar duke mos qenë i vetëdijshëm për deklarimin e vet lidhje me pranimin e fajësisë nga se ka menduar se është duke e pranuar faktin se ai ka qenë si kryesus e jo se ai ka bërë ndonjë shpërdorim dhe regjistrim të pasaktë zgjedhorë. Këtë pranim të fajësisë e ka bërë pa e kuptuar fare se po e pranon fajësinë për veprën penale të keqpërdorimit pasi që as në polici e as pranë prokurores së shtetit nuk ka bërë pranim të fajësisë dhe ka këmbëngulur se nuk ka bërë asnjë veprim në kundërshtim me ligjin dhe se ka mundur të ndodhë ndonjë gabim gjatë rinumërimit që duhet të vërtetohet. Mbrojtja e të akuzuarit thekson se gjykata e shkallës së parë nuk ka precizuar se cilën parti dhe cilët kandidatë i ka dëmtuar i akuzuari. Këtë gjendje faktike gjykata e shkallës së parë sipas mbrojtjes nuk ka mundur ta vërtetojë nga provat materiale si : Libri i votimeve, formulari i përputhjes së të dhënave dhe rezultateve, formulari i rezultateve të kandidatëve – Rinumërim, në të cilat prova nuk mund të dallohet për cilët kandidatë apo subjekte politike ka parregullësi. Sipas mbrojtjes së të akuzuarit gjykata e shkallës së parë nuk bënë lidhjen kauzale me pasojën pra nuk dihet se kush është i dëmtuar, nga provat e bashkangjitura nuk mund të vërtetohet se i akuzuari ka kryer veprën penale të falsifikimit të rezultatit të votimit dhe se gjykata e shkallës së parë është dashur që ta refuzojë pranimin e fajësisë.

Kolegji i Gjykatës së Apelit ka vlerësuar aktgjykimin e shkallës së parë , sipas ankesës së bërë, por edhe sipas detyrës zyrtare lidhur me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe ka ardhë në përfundim që aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk përfshihet me shkelje të dispozitave të procedurës penale .

Aktgjykimi i shkallës së parë është i qartë dhe konkretë, gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur kur ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet nga neni 248 të KPP lidhur me pranimin e fajësisë por edhe të nenit 246 të KPP-së e që ka të bëjë po ashtu me pranimin e fajësisë.

Siç shihet nga aktgjykimi gjykata pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurorisë ka njoftuar të akuzuarin për rëndësinë dhe pasojat e pranimit të fajësisë e për të cilat i akuzuari është deklaruar se i ka kuptuar të njëjtat dhe e pranon fajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar. Po ashtu edhe Prokurori i Shtetit është pajtuar me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit.

Pavarësisht pranimit të fajësisë nga ana e të akuzuarit gjykata e shkallës së parë në aktgjykim ka vlerësuar se e pranon pranimin e fajësisë pasi plotësohen të gjitha kushtet nga neni 248 të KPP e ndër kushtet e kërkuara është që pranimi i fajësisë të mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e prezentuara nga Prokurori i Shtetit për

plotësimin e aktakuzës të pranuar nga i pandehuri dhe çdo provë tjetër siç është edhe dëshmia e dëshmitarëve e paraqitur nga Prokurori i Shtetit ose i pandehuri.

Në këtë drejtim gjykata përveç pranimin të fajësisë ka theksuar se gjendja faktike përveç se kemi pranimin faji është vërtetuar edhe në bazë të provave materiale që gjenden në shkresat e lëndës siç janë: deklarata e të pandehurit e dhënë në polici me dt. 31.08.2020 si dhe në prokurori me datë 04.11.2020, libri i votimit, formulari i përpluthjes së të dhënave të rezultateve e krijuar në vendvotimin nr. 1704 C/11R dhe FPR e rinumëruar në QNR (kopje), formulari i përputhjes së të dhënave dhe rezultateve të kandidatëve (FRK) e krijuar në atë vendvotim dhe FRK e rinumëruar në QNR, tabela në exel e specifikuar me emrin e kandidatit, subjektit politik dhe pasqyra e votave të numruara në vendvotim dhe rinumërimin në QNR (vota të cilat janë shuar dhe hequr ) të gjitha në kopje.

Prandaj bazuar në këto prova të theksuara më lartë demantohen pretendimet e mbrojtësit të akuzuarit se i njëjti ka pranuar fajësinë por asesi që si kryetar i komisionit të ketë shkelur ligjin dhe të ketë falsifikuar rezultatin e votimeve dhe se pranimin e fajësisë e ka bërë pa e kuptuar fare se për çka po pranon dhe se ka pretenduar se në asnjë veprim nuk ka vepruar në kundërshtim me ligjin.

Meqë aktgjykimi i shkallës së parë nuk është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale si dhe gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë nuk kemi as shkelje të Ligjit Penal e që do të kushtëzonte anulimin e aktgjykimit.

Nga sa u tha më lartë, e në pajtim me dispozitën e nenit 401 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS  
PAKR.nr.99/21, më 29.03.2021

Procesmbajtëse,  
Leonita Lajçi\_\_\_\_\_

Kryetar i kolegjit- gjyqtari  
1. Abdullah Ahmeti \_\_\_\_\_

Anëtarët e kolegjit:

2. Dr.sc.Driton Muharremi\_\_\_\_\_

3. Vaton Durguti\_\_\_\_\_